



Në bazë të kërkesës së Drejtorisë për Mbrojtje Shpëtim dhe Shërbime Publike të Komunës së Deçanit, të dt.20.02.2019, nr.09-5264, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të Kompanisë Komunale të pastrimit "Higjiena", bazuar në nenin 14 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 dhe nenit 21 dhe 25 pika 7 të Statutit të Komunës së Deçanit, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt.28.02.2019, bie këtë:

V E N D I M

PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR NDËRTIMIN E OBJEKTIT TË KOMPAJNISË KOMUNALE TË PASTRIMIT "HIGJIENA"

I.

Caktohet lokacioni për ndërtimin e objektit të Kompanisë Komunale të pastrimit "Higjiena", Zona Kadastrale Hulaj, sipërfaqja e përcaktuar është 1500 m², pjesë e parcelës nr.0072-0, Certifikata P-70505078-00072-0, e evidentuar si Pasuri shoqërore-Kooperativa bujqësore, me sipërfaqe të përgjithshme prej 47353 m².

II.

Implementimin e këtij Vendimi do ta bëjnë: Drejtoria për Mbrojtje Shpëtim dhe Shërbime Publike dhe Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër e Komunës së Deçanit.

III.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

Me Vendim njoftohen: Drejtoria për Mbrojtje Shpëtim dhe Shërbime Publike, Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër dhe Arhivi i Komunës së Deçanit.

01.Nr.II-3

Deçan, dt.28.02.2019

KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIC OF KOSOVA REPUBLIKA KOSOVA	
KOMUNA E DEÇANIT MUNICIPALITY OF DECAN OPSTINA DECANI	
K. Komunës	7014
01	06.03.19
DEÇAN DECANI	



Kryesuesi i Kuvendit
Haki Shehaj



Në bazë të nenit 40.2 (b) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenit 25 pika 2. të Statutit të Komunës së Deçanit, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt.28.02.2019, merr këtë:

V E N D I M

PËR ORIENTIMIN E TË HYRAVE VETANAKE TË VITIT 2018 TË BARTURA NË VITIN BUXHETOR 2019

I.

Orientohen mjetet nga të hyrat vetanake të vitit 2018 të bartura në vitin buxhetor 2019, në shumën prej **355,556.73 €**, si në pasqyrën e paraqitur më poshtë:

-Kujdesi Primarë Shëndetësor (73900), Kategoria ekonomike _Paga dhe mëditje.....shuma prej 24.386,63€ euro, pagesa e kujdestarise se nates te hyra nga participimi dhe te lejuara me ligj mbi shendetesine.

Nën /Programi	Kodi i nën programit	Kodi funksional	Kategoria ekonomike	Nën kategorit ekonomike/zërat	Përshkrimi i nën kategorisë	BARTJA 2019
Sherbimet e Kujdesit Primar Shëndetësor	73900	0721	11	11110	Pagat Neto përmes listës së pagave	24.386,63€

-Zyra e Kryetarit (16015), Kategoria ekonomike_Subvencione dhe Transfere.....shuma prej 1.499,52€ euro, janë për subvencionimin e njerëzve me nevojë

Nën /Programi	Kodi i nën programit	Kodi funksional	Kategoria ekonomike	Nën kategorit ekonomike/zërat	Përshkrimi i nën kategorisë	BARTJA 2019
Zyra Kryetarit	16015	0111	20	21200	Subv.për Entit.Jopublike	1.499,52€

-Buxheti (17515), Kategoria ekonomike_mallera dhe shërbime....shuma prej 9.627,52€ euro, janë për pagesat e mbetuar te kontratës se pastrimit te objekteve komunale

Nën /Programi	Kodi i nën programit	Kodi funksional	Kategoria ekonomike	Nën kategorit ekonomike/zërat	Përshkrimi i nën kategorisë	BARTJA 2019
Buxheti	17515	0112	130	0130	Mallera dhe shërbime	9.625,52€

-Sherbimet Publike-Infrastrukturë Rrugore (18015),

Kategoria ekonomike_Shpëzimet Kapitale.....shuma prej 320.043,12€ euro, të dedikuara për projekte kapitale si:

Nën /Programi	Kodi nën programit	Kodi funksional	Kategori ekonomike	Përshkrimi i nën kategorisë	Kodi i projektit	Projektet	BARTJA 2019
Sherbime Publike.- Infrastrukturë Rrugore	18015	0451	30	Rekonstruim infrastrukturor i rrugëve lokale	48420	Rekonstruim infrastrukturor i rrugëve lokale	267.453,12€
Sherbime Publike.- Infrastrukturë Rrugore	18015	0451	30	Rekonstruimi i lapidareve Deçan Carrabreg Lumbardh LLoqan etj	48634	Rekonstruimi i lapidareve Deçan Carrabreg Lumbardh LLoqan etj	52.590,00€

II.

Për ekzekutimin e këtij vendimi do të kujdesen: - Zyra e Kryetarit, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Drejtoria për MSH dhe SHP, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale të KK Deçan.

III.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në uebfaqen e Komunesë.

IV.


Me Vendim njoftohen:MF-Departamenti për Buxhet dhe Financa, MAPL, Zyra e Kryetarit, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Drejtoria për MSH dhe SHP, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe Arhivi i KK Deçan.

01.Nr.II-7

Deçan,dt.28.02.2019

KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT


Kryesuesi i Kuvendit
Haki Shehaj





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇANI



Sipas kërkesës së K.F."Deçani" të dt.22.01.2019, nr.01-2236, për subvencionim të KF "Deçani", duke u mbështetur në nenin 40.2 (c) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenit 25 pika 3. të Statutit të Komunës së Deçanit, Kuvendi i Komunës së Deçanit me dt.28.02.2019, merr këtë:

V E N D I M

PËR SUBVENCIONIMIN E KF "DEÇANI"

- I. Aprovohen mjetet financiare për subvencionimin e KF "Deçani", **në shumën prej 10,000.00 € (dhjetmijeuero)**, mjete të cilat nevoiten për pagesën e personave zyrtar, transfere të lojtarëve, licencimin e lojtarëve dhe trajnerëve, pagesën e shpenzimeve të udhëtimit të lojtarëve, pagesën e kartonave, pagesën e paisjeve sportive etj.
Mjetet do të derdhen në gjyrollogarinë e Klubit Futbollistik "DEÇANI" në ProCredit Bank, nr. Gjyrollogarisë 1131268313000190, nr.fiskal 600829785, nr.biznesit 06002061.
- II. Mjetet financiare, si në pikën I. të këtij vendimi ndahen nga linja buxhetore e Zyrës së Kryetarit ose Drejtoris për Buxhet dhe Financa, në kategorinë e subvencioneve.
- III. Për realizimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa e KK Deçan.
- IV. Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në web faqen e Komunës.
- V. Me vendim njoftohen: KF "Deçani", Zyra e Kryetarit, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Arhivi i KK Deçan.

KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT

01.Nr.II-8/1

Deçan, dt.28.02.2019

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E DEÇANIT MUNICIPALITY OF DEÇAN
K. Komunës	7010
01	06.03.19



Kryesuesi i Kuvendit
Haki Shehaj



Në bazë të nenit 12 dhe 17 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe nenit 25 pika 7 të Statutit të Komunës së Deçanit, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e vet të mbajtur me dt.28.02.2019, bie këtë:

V E N D I M

MBI APROVIMIN E PLANIT KOMUNAL TË VEPRIMIT PËR EFIÇIENCËN E ENERGJISË (PKVEE) 2019- 2021

I.

Aprovohet Plani Komunal i Veprimit për Eficiencën e Energjisë (PKVEE) për Komunën e Deçanit 2019- 2021.

II.

Pjesë përbërse e këtij Vendimi është Plani Komunal i Veprimit për Eficiencën e Energjisë (PKVEE) për Komunën e Deçanit 2019- 2021.

III.


Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale , si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

Vendimi ju dërgohet: Kryetarit të Komunës, Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, Drejtorisë për MSH dhe SHP dhe Arhivit.

01.Nr.II-4

Deçan,dt.28.02.2019

KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT



Kryesuesi i Kuvendit:
Haki Shehaj